

RRUGËT RAJONALE DHE LOKALE TË KOSOVË VLERËSIMI MJEDISOR DHE SOCIAL

Plani i angazhimit të palëve të interesit



Republika e Kosovës
Ministria e Infrastrukturës

Përfundimtar
05 Janar 2016

RRUGËT RAJONALE DHE LOKALE TË KOSOVË VLERËSIMI MJEDISOR DHE SOCIAL

Plani i angazhimit të palëve të interesit

Projekti:	Rrugët rajonale dhe lokale të Kosovës - Vlerësim Mjedisor dhe Social
Raporti:	Plani i angazhimit të palëve të interesit
I hartuar nga:	Ministria e Infrastrukturës
I financuar nga:	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Konsulent:	Enova d.o.o. Sarajevo

Përmbajtja

1	HYRJE	4
1.1	Përshkrimi dhe konteksti i projektit të propozuar	4
1.2	Objektivi dhe fushëveprimi i dokumentit	4
2	KËRKESAT RREGULLATIVE	5
2.1	Legjislacioni i Kosovës	5
2.2	Politikat e BERZH-it	6
3	ANGAZHIMI PARAPRAK I PALËVE TË INTERESIT	7
4	PALËT E INTERESIT TË PROJEKTIT	8
5	PROGRAMI I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT	10
5.1	Qëllimi dhe përgjegjësia për implementimin e SEP	10
5.2	Mjetet e komunikimit në dispozicion	10
5.3	Publikimi i planifikuar i informacionit	10
5.4	Mjetet e planifikuara për informim dhe komunikim	11
5.5	Orari kohor	13
5.6	Informatat e siguruar nga kontraktorët	13
5.7	Kërkesa formale për informatë	14
6	MEKANIZMI I ANKESËS	14
7	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	15
	Shtojca 1: Grafiku i përpunimit të ankesave	17
	Shtojca 2: Formulari për ankesë publike	18

1 HYRJE

1.1 Përshkrimi dhe konteksti i projektit të propozuar

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po shqyrton mundësinë e sigurimit të financimit për Qeverinë e Kosovës në mbështetje të punimeve në përmirësimin e rrugëve nacionale në kuadër të "Kosova - Projekti i Rrugëve Rajonale dhe Lokale" (projekti).

Projekti përfshinë:

- **rindërtimi i shtresës së rrugës magjistrale në segmentet e poshtme:** Magjistralla N 25 - segmenti Kllokot - Gjilan në gjatësi prej 12 km, duke filluar në kryqëzimin nga Kllokotit deri në magjistrallen N 25 - 3 dhe përfundon në unazën e Gjilanit;
- Zgjerimi i rrugëve hyrje/dalje me katër-korsi në komunat: Gjilan, Ferizaj dhe Prizren. Këto segmente konsiderohen projekte prioritare në kuadër të Strategjisë së Transportit Multimodal (2012-2021) dhe Planit të Veprimit (2012-2016) të Kosovës.
 - Segmenti N25-2 i rrugës në hyrje të Gjilanit është rruga kryesore në hyrje të Komunës së Gjilanit nga drejtimi i kryeqytetit të vendit, Prishtina, dhe paraqet lidhjen më të shpejtë me autostradën A1 në Republikën e Serbisë. Ky segment është një degë e rrjetit kryesor nacional dhe rajonal të rrugëve të Kosovës.
 - Segmenti N2 i rrugës në hyrje të Ferizajt është lidhja më e shpejtë nga drejtimi i kryeqytetit të vendit, Prishtina, përmes komunës së Ferizajt për në Shkup, Maqedoni. Kjo në të ardhmen do të jetë rrugë tranzit e autostradës së ardhshme Prishtinë - Shkup R6, tani në ndërtim e sipër, që pritet të përfundojë gjër në vitin 2018.
 - Segmenti R107 i rrugës në hyrje të Prizrenit është rrugë e rëndësishme në hyrje të Komunës së Prizrenit nga drejtimi i Gjakovës, që shërben si lidhje e rëndësishme në mes të qyteteve kryesore të Kosovës.

Informacione më të detajuara mbi qëllimin dhe përfitimet e projektit, ndikimet e pritura mjedisore dhe sociale, si dhe zbutjen e planifikuar dhe masat monitoruese, janë në dispozicion në përmbledhjen jo-teknike të publikuar në kuadër të Projektit, si pjesë e pakos publike.

1.2 Objektivit dhe fushëveprimi i dokumentit

Ky Plan i Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP) është përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës së Kosovës (Ministria), si agjenci implementuese e projektit, në mënyrë që t'ia komunikojnë qartë të gjitha palëve të interesit programin e angazhimit të palëve të interesit që do të zbatohet gjatë gjithë ciklit të Projektit.

Objektivi i këtij SEP është që të përmirësojë dhe të lehtësojë vendimmarrjen që lidhet me projektin dhe t'i ofrojë mundësi për përfshirje aktive dhe me kohë të gjitha palëve të interesit, dhe t'i ofrojë mundësi të gjitha palëve të interesit të shprehin opinionet dhe shqetësimet e tyre që mund të ndikojnë vendimet e Projektit.

Ky SEP do të përditësohet rregullisht me qëllim të pasqyrimin të progresit të Projektit, në veçanti në lidhje me orarin e punëve të planifikuara.

2 KËRKESAT RREGULLATIVE

2.1 Legjislacioni i Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 41, përcakton se çdo person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose klasifikimit të sigurisë. Kjo bazë ka çuar në miratimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike Nr. 03/L-215¹ (në tekstin e mëtejshëm: LQDP), që garanton garanton të drejtën e çdo personi fizik dhe juridik për të pasur qasje, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, pas aplikimit paraprak, në dokumentet e mbajtura, të hartuara apo të pranuar nga institucionet publike. Përjashtimisht, qasja në informata mund të kufizohet në rrethana të caktuara, duke krijuar një përjashtim në çdo rast të veçantë, vetëm sipas mënyrës, situatës dhe kushteve të përcaktuara nga LQDP (siç është siguria kombëtare, mbrojtja dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, siguria publike, privatësia, interesa komerciale dhe të tjera ekonomike, etj). Procedura e marrjes së informacionit sipas këtij ligji është përshkruar më hollësisht në këtë SEP nën 5.7 - Kërkesa formale për informacion.

Përveç kësaj, legjislacioni i aplikueshëm mjedisor në Kosovë, veçanërisht Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025² përcakton detyrimin e institucioneve qendrore dhe lokale dhe të gjitha organizatave tjera të autorizuar që rregullisht, në kohë dhe objektivisht të informojnë publikun për gjendjen e mjedisit, cilësinë e mjedisit dhe emisionet, masat paralajmëruese, dhe ndotjen që mund të paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, ndërsa në anën tjetër t'a sigurojë pjesëmarrjen e publikut në proceset vendimmarrëse (duke paraqitur mendime, komente dhe sugjerime autoriteteve kompetente gjatë dëgjimeve publike) dhe duke i dhënë publikut të drejtën për qasje në regjistrat ose në të dhënat që përmbajnë të dhëna të rëndësishme mjedisore.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214³ rregullon procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), duke përfshirë edhe detyrimin e autoriteteve për të mbajtur dëgjime publike për projektet që kërkojnë VNM. Ky ligj parashikon që projektet e listuara në shtojcën 1 të saj (në mënyrë të veçantë, zgjerimin/ndërtimin e një rruge ekzistuese prej 5 km ose më shumë në gjatësi të vazhdueshme) duhet t'i nënshtrohen procedurës së VNM-së,⁴ ndërsa projektet me parametra nën këtë prag (të listuara në shtojcën 2) duhet të shqyrtohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës në bazë të rastit për të vendosur nëse do t'i nënshtrohen procedurës së VNM-së.⁵ Shqyrtimi bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në shtojcën 3 të Ligjit. Për më tepër, sipas shtojcave 1 dhe 2 të Ligjit, VNM apo lëshimi i pëlqimit mjedisor nuk janë të nevojshme për përmirësimin e rrugëve (rehabilitimi i sipërfaqes brenda shtrirjes ekzistuese).⁶

Duke pasur parasysh faktin se implementimi i projektit kërkon blerjen e tokës, duhet theksuar se Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139⁷ i cili rregullon shpronësim dhe zhvendosjet në Kosovë, përfshinë edhe dispozitat mbi procedurën e komunikimit dhe informimit gjatë blerjes së tokës. Sipas këtij ligji, nga Organi Shpronësues kërkohet që brenda 10 ditëve të punës, pas miratimit të vendimit për miratimin

¹ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/nr. 88/25, nëntor 2010

² Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, viti IV/nr. 50/06, prill 2009

³ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/nr. 83/29 tetor 2010

⁴ Kjo vlen për rrugën në hyrje të Ferizajt

⁵ Kjo vlen për rrugët në hyrje të Gjilanit dhe Prizrenit

⁶ Kjo vlen për rehabilitimin e magjstrales me dy korsi të rrugës nacionale N 25-3, segmenti Kllokot - Gjilan (12 km)

⁷ I datës 23 prill 2009, dhe i ndryshuar me Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-205 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/Nr. 91/10 dhjetor 2010

Rrugët rajonale dhe lokale të Kosovës - Vlerësim Mjedisor dhe Social

Plani i angazhimit të palëve të interesit

e kërkesës për shpronësim, t'ia dërgojë të gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme bartësit të identifikuar të të drejtave pronësore. Vendimi për miratim botohet në Gazetën Zyrtare dhe në gazetat e përditshme, dhe pasohet nga periudha 10-ditore gjatë së cilës palët e interesuara mund të paraqesin komente me shkrim pranë Organit Shpronësues. Organi Shpronësues obligohet të mbajë dëgjim publik brenda 15 ditësh në çdo komunë ku gjenden pronat që janë objekt i shpronësimit.

2.2 Politikat e BERZH-it

Dispozitat e Politikave Sociale dhe Mjedisore të BERZH (2014)⁸ (ESP) dhe të Politikave për Informim Publik (2014)⁹ (PIP) për konsultimet publike dhe për qasje në informacion janë marrë parasysh plotësisht me rastin e përgatitjes së këtij SEP.

- *Politikat Sociale dhe Mjedisore të BERZH*

BERZH ka miratuar një pako gjithëpërfshirëse të Kërkesave specifike të Performancës (KP) që projektet duhet t'i plotësojnë. *PR 10 e BERZH*: Publikimi i Informacionit dhe Angazhimi i palëve të interesit njih rëndësinë e angazhimit të hapur dhe transparent në mes të klientit, punonjësve të tij, komuniteteve lokale të prekura drejtpërdrejt nga projekti dhe palët tjera të interesit, si element thelbësor i praktikave të mira ndërkombëtare dhe qytetarisë korporative. Angazhimi i grupeve të interesit përfshinë identifikimin dhe analizën e palëve të interesit, planifikimin e angazhimit të palëve të interesit, shpalosjen e informacionit, konsultimin dhe pjesëmarrjen, mekanizmin e ankesave dhe raportimin e vazhdueshëm tek palët e interesit.

- *Politikat për Informacionin Publik të BERZH (2014)*

PIP i BERZH-it përcakton se si BERZH jep informacione shpjeguese dhe konsultohet me palët e interesit në mënyrë që të nxisin ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe veprimeve të saj. Dokumentacioni i projektit do të publikohet në faqen e internetit të BERZH, në përputhje me këtë politikë.

⁸ Mund të shihet në: <http://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmental-and-social-policy-esp.html>

⁹ Mund të shihet: <http://www.ebrd.com/what-we-do/strategies-and-policies/public-information-policy.html>

3 ANGAZHIMI PARAPRAK I PALËVE TË INTERESIT

Gjatë fazës përgatitore të projektit, Ministria e Infrastrukturës të Kosovës ka iniciuar konsultime me komunat e përfshira në Projekt (Komuna Ferizaj, Gjilan, Prizren, Kllokot, Partesh) për t'i përcaktuar veprimet prioritare për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrugëve.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, komunat e përfshira kanë ndërmarrë veprime për t'i identifikuar grupet përkatëse të palëve të interesit dhe për të siguruar informata brenda zonës së projektit në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet formave të ndryshme të takimeve formale dhe joformale me kryetarët e komunave dhe komunitetet lokale, si dhe përmes takimeve publike me qëllim të diskutimit të çështjeve të ndryshme me rëndësi për komunitetet lokale, pasi që dihet se Projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës në komunitetet lokale.

Dëgjimet publike me komunitetet lokale u mbajtën gjatë procesit të miratimit të Planit Zhvillimor Komunal, Planit Zhvillimor Urban dhe Planeve Rregulluese Urbane për komunat Ferizaj, Gjilan dhe Prizren, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të planifikimit hapësinor në Kosovë.¹⁰

Tabela 1: Dokumentacioni i planifikimit i hartuar për zonat e projektit

Segmenti i rrugës	Dokumentacioni i planifikimit i hartuar për zonat e projektit
Segmenti M25-2 i rrugës në hyrje të Gjilanit	<ul style="list-style-type: none">Plani zhvillimor komunal i Gjilanit (2008)Plani zhvillimor urban i Gjilanit
Segmenti M2 në hyrje të Ferizajt	<ul style="list-style-type: none">Plani zhvillimor komunal i Ferizajt (2011)Plani zhvillimor urban i FerizajtPlanet rregullative urbane për rrugën M2Vlerësimi strategjik mjedisor për zonën e Ferizajt
Segmenti R107 në hyrje të Prizrenit	<ul style="list-style-type: none">Plani zhvillimor komunal i Prizrenit (2011)Plani zhvillimor urban i Prizrenit (2011)Planet rregullative urbane për zonën e parkut të biznesit (2011)Drafti i vlerësimit të ndikimit social për zonën e parkut të biznesit (2011)Plani zhvillimor komunal i Prizrenit (2025) Raporti (draft) i vlerësimit të ndikimit social (VNS) (2015)
Rruga nacionale M 25-3 segmenti Kllokot - Gjilan	<ul style="list-style-type: none">Drafti i vlerësimit të ndikimit social për zgjerimin e rrugës M25-3, Gjilan – Prishtinë (2015)Plani zhvillimor komunal i Gjilanit (2008)Plani zhvillimor urban i Gjilanit

Me përjashtim të dëgjimeve publike të përshkruara dhe formave të tjera të komunikimit, nuk u mbajtën konsultime me komunitetet lokale dhe me publikun e gjerë në lidhje me Projektin.

¹⁰ Ligji për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 30/23, Gusht 2013

4 PALËT E INTERESIT TË PROJEKTIT

Palët e interesit të projektit janë identifikuar me qëllim të adresimit të kërkesave për konsultim. Këto palë të interesit duhet të informohen për aktivitetet e projektit dhe të konsultohen gjatë tërë ciklit të projektit. Ata përfshijnë personat ose grupet që janë:

- Direkt dhe/apo indirekt të prekur nga projekt;
- Kanë interesa të caktuara në Projekt dhe nga aktivitetet e tij;
- Kanë mundësinë që të ndikojnë tek vet projektin dhe në rezultatet finale të tij;

Kujdes të veçantë duhet kushtuar Personave të Prekur nga Projekti (PAP) dhe grupeve të cënueshme. Grupet e cënueshme mund të kenë nevojë të informohen dhe të konsultohen në mënyrë të veçantë, të përshtatshme me nevojat e tyre dhe me statusin e cënueshmërisë.

Tabela 2: Palët e identifikuar të interesit për projektin

Nr.	Grupi i identifikuar i palëve të interesit	Përkufizimi i palëve të interesit
1.	Personat e Ndikuar nga Projekti ¹¹	Individët, familjet dhe bizneset, pronarët ose shfrytëzuesit, të cilët do të preken nga blerja e tokës dhe/ose përdorimi i tokës (të përhershëm/të përkohshëm) në lidhje me aktivitetet e Projektit
2.	Banorët dhe bizneset lokale në zonën e Projektit	Komunitetet lokale, banorët dhe bizneset e vendosura në afërsi të segmenteve rrugore që do të zgjerohen/ndërtohen që do të preken nga aktivitetet e Projektit (kufizimet e qasjes dhe/ose çrregullimet për shkak të punimeve të ndërtimit)
3.	Shfrytëzuesit e rrugëve hyrëse	Popullata që shfrytëzon rrugët, që mund të preken direkt ose indirekt nga aktivitetet e Projektit
4.	Grupet e cënueshme që ndikohen ¹²	Grupet e cënueshme janë njerëzit të cilët, në bazë të identitetit gjinor, orientimit seksual, fesë, etnisë, gjendjes indigjene, moshës, paaftësisë, disavantazhit ekonomik apo statusit shoqëror mund të preken më negativisht nga Projekti sesa të tjerët, gjë që mund t'ia kufizojë aftësinë e tyre në pretendimin ose ta kapin përparësinë e përfitimeve të projektit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të moshuarit dhe të sëmurët; ▪ Personat me nevoja të veçanta; ▪ Familjet me të ardhura shumë të ulët ose pa të ardhura, veçanërisht ato që varen nga transporti publik; ▪ Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme që banojnë në afërsi të zonave të ndërtimit të rrugëve apo kalojnë nëpër vendet e ndërtimit për çdo ditë.
	Autoritetet qeveritare brenda zonës së projektit, ministritë përkatëse dhe institucionet publike: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ministria e Infrastrukturës ▪ Ministria e Financave ▪ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ▪ Agjensioni për Mbrojtjen e 	Institucionet e përfshira drejtpërdrejt në implementimin e Projektit dhe palët me interesa të veçanta në këtë projekt, të cilët gjithashtu kanë aftësinë për ta ndikuar hartimin dhe rezultatin përfundimtar të projektit

¹¹ Numri i saktë i personave të prekur nga blerja e tokës për nevojat e Projektit do të dihet pas kryerjes së studimeve të shpronësimit.

¹² Gjatë vizitave në terren në zonën e projektit të realizuara gjatë përgatitjes së këtij SEP, nuk u identifikuan grupe të caktuara të cënueshme; megjithatë, pasi që nuk ka pasur regjistrim popullsisë apo anketë socio-ekonomike në këtë fazë të projektit, ato grupe të mundshme megjithatë janë përfshirë në listën e palëve të interesit.

Rrugët rajonale dhe lokale të Kosovës - Vlerësim Mjedisor dhe Social
Plani i angazhimit të palëve të interesit

Nr.	Grupi i identifikuar i palëve të interesit	Përkufizimi i palëve të interesit
	<p>Mjedisit të Kosovës</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Agjencia Ekzekutive e Inspektoratit të Punës ▪ Komuna e Ferizajt ▪ Komuna e Gjilanit ▪ Komuna e Prizrenit ▪ Komuna e Kllokotit ▪ Komuna e Parteshit ▪ Policia e Kosovës 	
5.	OJQ-të e interesuara në nivel lokal dhe nacional	Organizatave jo-qeveritare (OJQ) në fusha të ndryshme të aktiviteteve, dhe organizatat tjera të shoqërisë civile që tregojnë interes për Projektin dhe/ose e kanë aftësinë për ta ndikuar Projektin ¹³
6.	<p>Të punësuarit dhe punëtorët</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të punësuarit dhe punëtorët e Ministrisë (266 të punësuar deri në nëntor 2015) ▪ Sindikata e nëpunësve civil të Ministrisë së Infrastrukturës që vepron nën ombrellën e Federatës së Sindikatave të Nëpunësve Civil të Republikës së Kosovës ▪ Punëtorët e ndërtimit, punëtorët e përkohshëm, nënkontraktorët dhe kompanitë e kontraktuara për të monitoruar dhe mbikëqyrur punët 	Palët e interesuara me rëndësi të madhe për suksesin e projektit të cilat janë direkt ose indirekt përgjegjës për planifikimin dhe implementimin e Projektit

¹³ Asnjë OJQ nuk ka shprehur ndonjë interes të veçantë në lidhje me Projektin deri më sot.

5 PROGRAMI I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT

Në mënyrë që t'i përgjigjet në mënyrë adekuate nevojave të grupeve të ndryshme, janë dizajnuar kanalet e komunikimit dhe të informimit për të gjitha palët e interesit të identifikuar në përputhje me nevojat e tyre.

5.1 Qëllimi dhe përgjegjësia për implementimin e SEP

Ministria pranon se angazhimi kuptimplotë me komunitetet lokale, njerëzit e prekur nga projekti (PAP) dhe aktorët tjerë do ta sigurojnë suksesin e projektit. Procesi i angazhimit do të përdoret për të marrë komente dhe sugjerime për zhvillimin e Projektit, të cilat mund ta përmirësojnë dizajnimin e projektit dhe të çojë në përfitime më të mëdha lokale. Në mënyrë që të sigurohet një proces adekuat dhe me kohë i konsultimit, Ministria ka themeluar Njësinë Implementuese të Projektit ("NJIU") e përbërë nga përfaqësues të Ministrisë dhe e mbështetur nga Konsulenti për bashkëpunim teknik, që do të jetë përgjegjëse për zbatimin e SEP, duke përfshirë komunikimin me komunat, komunitetet e prekura lokale dhe PAP.

Për më tepër, nga të gjithë kontraktorët e ngarkuar me kryerjen e aktiviteteve specifike të projektit do të kërkohet që ta zbatojnë SEP. Dispozitat e implementimit të SEP, duke përfshirë mekanizmin e ankesave, që i është besuar kontraktorëve, do të përcaktohen në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratat e nënshkruara me kontraktorët.

5.2 Mjetet e komunikimit në dispozicion

Ministria dhe komunat e përfshira përdorin kanalet e mëposhtme për komunikim të rregullt dhe të drejtpërdrejtë me palët e interesit:

- Faqja zyrtare e Ministrisë në internet (<http://mi-ks.net/>)
- Faqja zyrtare e komunës së Ferizajt në internet (<https://kk.rks-gov.net/ferizaj/>)
- Faqja zyrtare e komunës së Gjilanit në internet (<https://kk.rks-gov.net/ferizaj/>)
- Faqja zyrtare e komunës së Prizrenit në internet (<https://kk.rks-gov.net/ferizaj/>)
- Faqja zyrtare e komunës së Klllokotit në internet (<https://kk.rks-gov.net/ferizaj/>)
- Faqja zyrtare e komunës së Parteshit në internet (<https://kk.rks-gov.net/ferizaj/>)
- Telefoni, posta, faksi ose e-maili për pyetjet për Zyrën për Informim Publik në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës
- Shpalljet publike që i kumtohen mediave (radio lokale dhe stacione televizive, gazeta ditore)

5.3 Publikimi i planifikuar i informacionit

Ministria planifikon ta publikojë dokumentacionin dhe informatat e poshtme në lidhje me projektin:

- Këtë Plan të Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP)
- Përshkrimin e projektit dhe më të rehat sa i përket progresit në implementimin e projektit;
- Informatat mbi shëndetin dhe sigurinë e komunitetit, rreziqet dhe ndikimet (duke përfshirë çdo kufizim që pritet në lidhje me rrugët a qasjes dhe punimet e ndërtimit) si dhe masat zbutëse të propozuara;
- Përmbledhjen jo-teknike (NTS) e projektit;
- Kornizën e blerjes së tokës (LAF);
- Përmbledhjen e konkluzave nga takimet konsultative dhe të diskutimeve të mbajtura publike;
- Formularin për ankesë dhe formularin për kërkesë për informacion.

Dokumentet do të jenë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe serbe (si dhe në gjuhën angleze, kur të jenë në dispozicion) menjëherë pas fillimit të projektit në faqet e internetit të Ministrisë dhe komunave të përfshira, si dhe të shtypura në letër në ambientet e Ministrisë në adresën:

Rrugët rajonale dhe lokale të Kosovës - Vlerësim Mjedisor dhe Social
Plani i angazhimit të palëve të interesit

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS

Adresa: Ish ndërtesa e Gërmisë,
10000, Prishtinë
Republika e Kosovës

Këto dokumente dhe informata do të mbesin në domenin publik gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

5.4 Mjetet e planifikuara për informim dhe komunikim

Ministria, së bashku me komunat e përfshira, do të kryejë konsultime publike dhe do t'i shpërndajë informatat të cilat reflektojnë çështjet kryesore me rëndësi për projektin. Të gjitha palët e interesit do të informohen me kohë për qëllimin e projektit dhe kontaktet për informata të mëtejshme, si dhe për disponueshmërinë e dokumentacionit të projektit, nëpër faqet e internetit të Ministrisë dhe komunave të përfshira, si dhe përmes shpalljeve në mediat e përditshme lokale (gazeta, TV ose radio). Vëmendje të veçantë do t'i kushtohet përdorimit adekuat të gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Informatat mbi nivelin, kohën dhe kohëzgjatjen e punimeve të planifikuara të ndërtimit, dhe për çdo ndërprerje e shqetësim të pritshëm, do të publikohen përmes:

- Faqeve në internet të Ministrisë dhe komunave të përfshira;
- Mediave lokale (gazeta, TV ose radio).

Familjet dhe bizneset të prekura drejtpërdrejt nga blerja e tokës dhe nga okupimi i përkohshëm i tokës, do të vizitohen në mënyrë individuale dhe do të informohen edhe me shkrim në lidhje me ndikimet e projektit në pronat e tyre, veçanërisht rreth shtegut të saktë rrugor në çdo ngastër të tokës.

Banorët dhe bizneset në zonën e Projektit, të prekur drejtpërdrejt për çdo mbyllje të rrugëve dhe ndërprerje në qasje në pronat e tyre, do të informohen nëpërmjet letrave/fletushkave për kohëzgjatjen, kohën dhe punët e planifikuara.

Qasja në informata për grupet e cenueshme do të ndihmohet nga NJIU, ashtu siç është e përshtatshme, për çdo person/familje sipas nevojave dhe/ose gjendjes specifike të tyre, në bashkëpunim me departamentet komunale për punë sociale.

Ministria, së bashku me komunat përkatëse, do të caktojë dhe do të mbajë takime të rregullta me përfaqësuesit e grupeve të ndryshme të interesit, si më poshtë:

- Takimet publike konsultative janë parashikuar të zhvillohen të paktën një herë para fillimit të punimeve të ndërtimit, dhe të paktën një herë gjatë punimeve të ndërtimit. Takimet e tilla kanë për qëllim të sigurojnë se takimet e rregullta me të gjitha palëve të interesit janë të hapura për të gjitha palët e interesit.
Gjatë këtyre takimeve, Ministria paraqet rrjedhën e projektit, ndikimet e pritshme dhe masat e planifikuara zbutëse.
Pjesëmarrësit kanë mundësinë që t'i paraqesin mendimet dhe vërejtjet e tyre në lidhje me Projektin, si dhe të sugjerojnë zgjidhje të mundshme të çështjeve të ngritura, të cilat do të dokumentohen dhe adresohen në mënyrën e duhur në raportet e monitorimit për ankesat e pranuar dhe veprimet pasuese të ndërmarra që duhet përgatiten nga Ministria.
Nëse kërkohet, do të mbahen takime të ndara për të siguruar angazhim përgjegjës gjinor të palëve të interesit.
- Takimet konsultative të komunitetit lokal kanë për qëllim që të angazhojnë në procesin e konsultimit individët, ekonomitë familjare dhe bizneset e prekura nga aktivitetet e ndërtimit, dhe do të organizohen në bazë të nevojave në komuniteteve lokale.
- Takimet individuale konsultative synojnë që të angazhojnë grupet individuale të palëve të interesit në

Rrugët rajonale dhe lokale të Kosovës - Vlerësim Mjedisor dhe Social
Plani i angazhimit të palëve të interesit

lidhje me çështje të caktuara, dhe do të organizohen sipas nevojave. Këto takime mund të iniciohen nga Ministria ose nga cilido grup i identifikuar i interesit.

- Dëgjimet publike do të mbahen me kërkesë nga legjislativi lokal për ta konsultuar publikun në lidhje me përmbajtjen e VNM-së dhe blerjen e tokës si dhe për dokumente tjera, siç është përshkruar në seksionet e mëparshme të këtij dokumenti.

Tabela 3: Mjetet e komunikimit me palët e interesit

Pala e interesit	Çështjet përkatëse	Komunikimi/mediumet e propozuara
Personat e Prekur nga Projekti	Sigurimi i informatave me kohë në lidhje me aktivitetet e blerjes së tokave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Takimet individuale konsultative për t'i diskutuar ndikimet e Projektit ▪ Publikimi i informatave përmes faqeve në internet të Ministrisë dhe komunave të përfshira dhe nëpër mediumet e përditshme
Banorët dhe bizneset lokale në zonën e Projektit	Sigurimi i informatave me kohë mbi aktivitetet e ndërtimit, vonesat e mundshme në trafik, mbylljen e rrugëve dhe kufizimet në qasje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shpërndarja e letrave/fletëpalosjeve me informata në lidhje me kohëzgjatjen, kohën dhe nivelin e punëve të planifikuara për banorët/bizneset e prekura drejtpërdrejt nga çdo mbyllje e rrugëve dhe nga ndalesat në qasje në pronat e tyre ▪ Takimet publike dhe takimet konsultative me komunitetin lokal për të diskutuar ndikimet e Projektit nëpër komunat përkatëse ▪ Publikimi i informatave përmes faqeve në internet të Ministrisë dhe komunave të përfshira dhe nëpër mediumet e përditshme
Shfrytëzuesit e rrugëve që mbulohen nga Projekti	Sigurimi i informatave me kohë në lidhje me aktivitetet e ndërtimit/rindërtimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Publikimi i informatave përmes faqeve në internet të Ministrisë dhe komunave të përfshira dhe nëpër mediumet e përditshme ▪ Takimet publike konsultative nëpër komunat përkatëse
Grupet e cenushme që ndikohen (sidomos nëse ata janë të prekur nga blerja e tokës ose zhvendosja e detyruar)	Sigurimi i informatave me kohë në lidhje me aktivitetet e shpronësimit Asistencë në interpretimin dhe kuptimin informatave të dorëzuara	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Takime publike konsultative për të diskutuar ndikimet e Projektit në komunat përkatëse (përfshirë shkollat lokale, ku nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme njihen si grupe të prekura dhe të cenushme) ▪ Takimet individuale të nevojshme për të siguruar informata dhe ndihmë për t'i kuptuar informatat e dhëna dhe dokumentacionin e dorëzuar
Autoritetet qeveritare brenda zonës së projektit, ministrinë përkatëse dhe institucionet publike: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ministria e Infrastrukturës ▪ Ministria e Financave ▪ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ▪ Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës ▪ Agjencia Ekzekutive e Inspektoratit të Punës ▪ Komuna e Ferizajt ▪ Komuna e Gjilanit ▪ Komuna e Prizrenit ▪ Komuna e Kllokotit 	Sigurimi i informacionit në kohë për ndërtimin dhe punimeve zgjerimin e planifikuar të rrugëve, konsultime në lidhje me planet e përgatitura dhe për dokumentacionet Konsultimet me autoritetet përkatëse qeveritare në lidhje me aktivitetet e Projektit të ndërmarra nga Ministria	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kontakte të rregullta nëpërmjet kanaleve të brendshme të komunikimit, siç janë kontaktet dhe takimet me përfaqësuesit e komunave, duke përfshirë kryetarët e komunave, zëvendës kryetarët e komunave që vijnë nga komunitetet pakicë, departamentet e Kadastrës dhe Urbanizmit, departamentet e shërbimit publik, Zyrat lokale për komunitet dhe kthim, Zyrat për të Drejtat e Njeriut, Zyrat e informimit, etj.

Rrugët rajonale dhe lokale të Kosovës - Vlerësim Mjedisor dhe Social
Plani i angazhimit të palëve të interesit

Pala e interesit	Çështjet përkatëse	Komunikimi/mediimet e propozuara
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Komuna e Parteshit ▪ Policia e Kosovës 		
OJQ-të e interesuara në nivel nacional dhe lokal	Sigurimi me kohë i informatave, i komunikimit dhe konsultimit, si dhe menaxhimi i ankesave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Publikimi i informatave përmes faqeve në internet të Ministrisë dhe komunave të përfshira dhe nëpër mediimet e përditshme ▪ Takimet publike konsultative dhe takimet konsultative sipas nevojës
Të punësuarit dhe punëtorët e Ministrisë		
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të punësuarit dhe punëtorët e Ministrisë; ▪ Sindikata e shërbyesve civil të Ministrisë së Infrastrukturës që vepron nën ombrellën e Federatës së Sindikatave të shërbyesve Civil të Republikës së Kosovës 	Sigurimi me kohë i informatave rreth Projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Tabela e brendshme e Ministrisë për informim ▪ Trajnimet sipas nevojës
Punëtorët e ndërtimtarisë, nënkontraktorët apo kompanitë e kontraktuar për monitorimin dhe mbikëqyrjen e punimeve	Procedura e ankimit, Kodi i Sjelljes dhe rregulloret për sigurinë dhe shëndetin në punë, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Informatat në kontrata ▪ Komunikimi nëpërmjet NJIU dhe inxhinierët tjerë mbikëqyrës ▪ Trajnimi sipas nevojës

5.5 Orari kohor

Takimi i parë konsultativ publik do të organizohet gjatë fazës së tenderit dhe pas kontraktimit të Konsulentit për bashkëpunim teknik të lartpërmendur. Orari dhe vendi i caktuar për takimet publike konsultative do të përcaktohet saktësisht nga ana e Ministrisë, pasi të vendoset data e fillimit të projektit. Takimi i parë publik do të organizohet brenda një muaji nga data zyrtare e fillimit të Projektit. Të gjitha palët e interesit do të informohen për datën, kohën dhe vendin e saktë ku do të zhvillohet takimi konsultativ, të paktën 7 ditë përpara, nëpërmjet publikimit nëpër faqet e internetit të Ministrisë dhe të komunave të përfshira, si dhe në ditore gazeta/radio/stacione televizive.

Të gjitha informatat mbi Projektin që do të vihen në dispozicion të publikut, dhe të shkruhen në SEP, do të publikohen para takimit të parë publik.

5.6 Informatat e siguruar nga kontraktorët

Gjatë punëve ndërtimore, kontraktorët do të dorëzojnë informata në bazë mujore pranë Ministrisë në lidhje me mbarëvajtjen e punëve. Orari i punimeve dhe i ndryshimeve të mundshme në orarin e punimeve i dorëzohet autoritetet komunale rreth 2 javë para fillimit të punëve ndërtimore. Oraret japin informatat mbi fillimin dhe përfundimin e punimeve, gjë që mund të ndikojë grupet e prekura (siç janë ndryshimet në regjimin e transportit/regjimin e furnizimit me ujë/energji elektrike, dhe qasje në rrugë, zhurmë dhe pluhur për shkak të punimeve). Ministria në bashkëpunim me komunat do të jetë përgjegjëse informimin me kohë të publikut në lidhje me punët e planifikuara ndërtimore në përputhje me përditësimet nga Kontraktuesi. Kontraktorët janë të detyruar të zhvillojnë planet e angazhimit për projektin, duke përfshirë mekanizmin e ankesave për publikun, si pjesë e Planit për Monitorim dhe Menaxhim Social dhe Mjedisor të Ndërtimit dhe ta zbatojë atë në raport me punimet për të cilat janë kontraktuar.

5.7 Kërkesa formale për informatë

Në rast se Ministria pranon ndonjë kërkesë zyrtare për qasje në informatë, ajo do t'i zbatojë dispozitat dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike Nr. 03/L-215¹⁴ të përkrahura më hollësisht në Kapitullin 2: Kërkesat rregullative. Të gjitha kërkesat për qasje në dokumente duhet t'i drejtohen Zyrës për Informim Publik të Ministrisë, e themeluar në pajtim me Ligjin. Në rast se kjo zyrë nuk ka informatën e kërkuar apo nuk ka qasje në atë informatë, kërkohet që brenda 5 ditëve kalendarike nga dita e pranimit, ta përcjellë kërkesën pranë organizatës kompetente, dhe ta njoftojë kërkuesin në lidhje me masën e ndërmarrë. Nga autoritetet publike kërkohet t'i kthejnë përgjigje kërkuesit brenda 7 ditëve, për t'i lejuar qasje në dokumentet e kërkuara, ose ta njoftojnë kërkuesin për arsyet e refuzimit të plotë apo të pjesshëm. Në rast të refuzimit të plotë apo të pjesshëm, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë, brenda 15 ditëve, të paraqesë një kërkesë të re për shqyrtimin e çështjes.

Në rast të pakënaqësisë me vendimin e autoritetit publik, kërkuesit kanë të drejtë t'i drejtohen Institucionit të Ombudspersonit¹⁵ - një autoritet i pavarur me përgjegjësi të caktuar zyrtare për ofrimin e ndihmës falas për qytetarët në qasjen në dokumentet e nevojshme në rast se qasja i është refuzuar. Institucioni i Ombudspersonit ka selinë në Prishtinë dhe zyrat rajonale në zyrat përfaqësuese në Prizren, Gjiilan, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe Graçanicë.

Informatat kontaktuese:

Zyra kryesore në Prishtinë

Thirrjet falas për aplikuesit: 0800 15555

Tel: +381 (0) 38 223 782; +381 (0) 38 223 783 or +381 (0) 38 223 784; +381 (0) 38 223 789

Faksi: +381 (0) 38 223 790

Adresa e postës elektronike:

info@ombudspersonkosovo.org

Adresa:

Institucioni i Avokatit të Popullit

Bregu i Diellit, rr. "Enver Maloku", nr. 28

10000 Prishtinë, KOSOVË

Uebajti:

www.ombudspersonkosovo.org (në dispozicion në shqip, serbisht, turqisht dhe anglisht)

6 MEKANIZMI I ANKESËS

Ministria do ta krijojë një regjistër për ankesa. Çdo koment apo shqetësim mund t'i kumtohet Ministrisë ose Kontraktorit me gojë ose me shkrim (me postë ose e-mail) ose duke plotësuar formularin e ankesave (shih shtojcën 2), pa ndonjë kosto në emër të ankuesit. Të gjitha ankesat do të regjistrohen në regjistër dhe i caktohet një numër, dhe konfirmohet brenda 7 ditëve kalendarike.

Çdo ankesë do të regjistrohet në regjistër me të dhënat e mëposhtme:

- Përshkrimi i ankesës;

¹⁴ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/nr. 88/25, nëntor 2010

¹⁵ Kushtetuta e Kosovës përcakton rolin dhe kompetencat e Ombudspersonit të cilat përfshijnë monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave juridik dhe fizik nga veprimet apo mosveprimet e jashtëligjshme dhe të parregullta nga ana e autoriteteve publike. Ombudspersoni kryen hetime, nxjerr rekomandime, publikon raporte dhe ofron shërbime falas dhe avokim publik për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Rrugët rajonale dhe lokale të Kosovës - Vlerësim Mjedisor dhe Social Plani i angazhimit të palëve të interesit

- Data e konfirmimit të pranimit që i dërgohet ankuesit;
- Përshkrimi i veprimeve të ndërmarra (hetim, masa korigjuese) dhe
- Data e zgjidhjes dhe mbylljes së rastit/kthimi i komenteve tek ankuesi.

Ministria do t'i bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta adresuar ankesën pas pranimit të saj. Nëse Ministria nuk është në gjendje t'i adresojë çështjet e ngritura nëpërmjet veprimit të menjëhershëm korigjues, atëherë do të identifikohet veprimi afatgjatë korigjues. Ankuesi do të njoftohet në lidhje me veprimet korigjuese të propozuara dhe për veprimet pasuese korigjuese brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të ankesës.

Nëse Ministria nuk është në gjendje që ta trajtojë çështjen e ngritur përmes mekanizmit të ankesave, ose në qoftë se nuk ka nevojë për ndonjë veprim, ajo e jep një shpjegim të detajuar/justifikim se pse kjo çështje nuk është adresuar. Përgjigja do ta përmbajë edhe një shpjegim se si personi/organizata që ka paraqitur ankesën mund të vazhdojë me ankesë në rast se rezultati nuk është i kënaqshëm.

Në çdo kohë, ankuesit mund të shfrytëzojnë mjete tjera juridike në pajtueshmëri me kornizën ligjore të Kosovës.

Për punëtorët ekziston mekanizmi i veçantë i ankesave.

Informatat e kontaktit për pyetje dhe ankesa:

Për: Shefi i NJIP - z. Rame Qupeva,
Ministria e Infrastrukturës
Adresa: Ish ndërtesa e Gërmisë,
10000, Prishtinë
Republika e Kosovës
E-mail: mi.info@rks-gov.net
Tel/ fax: +381 (0)38 211 494
Tel.: +381 (0)38 200 28 ext. 505

Informatat e kontaktit për pyetje:

Zyra për Informim Publik:
Tel/ fax: +381 (0)38 200 28 ext. 507
Tel/ fax: +381 (0)38 200 28 ext. 041
Tel/ fax: +381 (0)38 200 28 ext. 048

7 MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Rezultatet e procesit të angazhimit të palëve të interesit do të përfshihen në raportet e monitorimit të përgatitura nga Ministria. Raporti i parë do të përgatitet 3 muaj pas fillimit të projektit, dhe do të vazhdojë në baza tremujore. Raportet do të bëhen publike në faqen e internetit të Ministrisë, me informatat e mëposhtme:

- Vendi dhe koha e mbajtjes së takimeve konsultative (duke përfshirë llojet e tjera të aktiviteteve të angazhimit) me informata rreth pjesëmarrësve;

Rrugët rajonale dhe lokale të Kosovës - Vlerësim Mjedisor dhe Social
Plani i angazhimit të palëve të interesit


- Çështjet dhe shqetësimet e ngritura gjatë takimeve konsultative dhe informatat se si çështjet e ngritura gjatë takimeve janë shqyrtuar nga Ministria, duke përfshirë edhe masat e zbatuara korrigjuese për qëllim për të adresuar ankesat;
- Numri dhe llojet e ankesave të ngritura në periudhën raportuese, me informata rreth ankesave të hapura, të zgjidhura dhe të mbyllura.

Përveç kësaj, Ministria dorëzon raportet vjetore mjedisore dhe sociale tek BERZH-ja duke përmbledhur ndikimet mjedisore dhe sociale, performancën rreth shëndetit dhe sigurisë, performancën rreth publikimit të informatave dhe konsultimeve dhe punën e mekanizmit të jashtëm të ankesave.

Njësia Implementuese e Projektit pranë Ministrisë është përgjegjëse për monitorimin e të gjitha aktiviteteve të angazhimit palëve të interesimit lidhur me projektin, duke siguruar plotësimin dhe përditësimin e këtij SEP, si dhe raportimin në BERZH.

RRUGËT RAJONALE DHE LOKALE TË KOSOVËS - VLERËSIM MJEDISOR DHE SOCIAL
Plani i angazhimit të palëve të interesit

Shtojca 1: Grafiku i përpunimit të ankesave



Rrugët rajonale dhe lokale të Kosovës - Vlerësim Mjedisor dhe Social
Plani i angazhimit të palëve të interesit

Shtojca 2: Formulari për ankesë publike

Numri i referencës:	
Emri i plotë (opsionale)	
Informatat kontaktuese	<input type="checkbox"/> Me postë: Shkruajeni adresën: _____ _____ _____
Si dëshironi t'ju kontaktojmë (me postë, me telefon, me email).	<input type="checkbox"/> Me telefon: _____ <input type="checkbox"/> Me e-mail
Gjuhët e preferuara të komunikimit	<input type="checkbox"/> Shqip <input type="checkbox"/> Serbisht <input type="checkbox"/> Anglisht (nëse ka mundësi)
Përshkrimi i incidentit për të cilin ankoheni	
	Çka ka ndodhur? Ku ka ndodhur? Kujt i ka ndodhur? Çfarë ishte rezultati i problemit?
Data e incidentit/ankesës	
	<input type="checkbox"/> Incident/ankesë që ndodhi vetëm një herë (data _____) <input type="checkbox"/> Ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë?) _____ <input type="checkbox"/> Është në vazhdimësi (tani po përballet me problemin)
Çfarë dëshironi të ketë ndodhur?	

Nënshkrimi: _____
Data: _____

Luteni ta ktheni këtë formular tek:
NJËSIA IMPLEMENTUESE E PROJEKTIT - MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS

z. Ramë Qupeva

Adresa: Ish ndërtesa e Gërmisë, 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

E-mail: mi.info@rks-gov.net

Tel/ Fax: +381 (0) 38 211 494, Tel.: +381 (0) 38 200 28 ext. 505